



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Nr. 1052/6 prot.

Datë 13.06.2023

**V E N D I M**  
**Nr. 492 /2023**

Komisioni i Prokurimit Publik, i përbërë nga:

Jonaid Myzyri	Kryetar
Fiorent Zguro	Nënkryetar
Kreshnik Ternova	Anëtar

Në mbledhjen e datës 13. 06.2023 shqyrtoi kërkesën me:

- Objekt:** Modifikimin e dokumenteve të procedurës së prokurimit “*Procedurë e hapur e thjeshtuar*” me Nr. REF-68226-05-04-2023, me objekt: “Blerje materiale elektrike”, me fond limit 2.405.800 Lekë pa TVSH, parashikuar për t’u zhvilluar në datën 19.05.2023 nga autoriteti kontraktor, “ECO-ELB” SH.A.
- Ankimues:** Operatori ekonomik “EVIA 20” SHPK  
*Adresa: Rr:Fier Zharrës, Km 0, Fier.*
- Autoriteti Kontraktor:** “ECO-ELB” SH.A  
*Adresa:Lagjja “Brigada 17 Sulmuese”, Bulevardi “Qemal Stafa”, Elbasan.*
- Baza Ligjore:** Ligji nr. 162/2020 “*Për Prokurimin Publik*”, Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “*Për miratimin e rregullave të prokurimit publik*”, i ndryshuar, Vendimi i Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766, datë 13.10.2021 “*Për miratimin e rregullave për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik*”, Neni 4 i Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 “*Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit*”

*Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19”.*

Komisioni i Prokurimit Publik pasi shqyrtoi ankesën e paraqitur nga operatori ekonomik ankimues dhe pasi diskutoi çështjen në tërësi,

**Vëren:**

**I**

*Vlerësimi paraprak*

I.1. Vlera limit e përlogaritur për procedurën e prokurimit objekt-ankimi është nën kufirin e ulët monetar, ndaj shqyrtimi dhe vendimmarrja do të bëhet nga tre anëtarë, në përputhje me pikën 1, të nenit 30 të ligjit nr. 162/2020 “*Për prokurimin publik*” dhe Rregullat e Prokurimit Publik.

I.2. Operatori ekonomik ka *prima facie* interes në këtë procedurë prokurimi dhe për këtë arsye legjitimohet për të paraqitur ankesë në lidhje me të.

I.3. Operatori ekonomik ankimues ka paraqitur ankesë pranë autoritetit kontraktor dhe njëherazi pranë Komisionit të Prokurimit Publik, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në ligjin nr. 162/2020 “*Për prokurimin publik*”.

I.4. Ankimuesi ka respektuar afatet ligjore të paraqitjes së ankesës pranë autoritetit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik.

**II**

*Rrethanat e çështjes*

II.1. Në datën 09.05.2023 është publikuar në Sistemin e Prokurimeve Elektronike procedura e prokurimit “*Procedurë e hapur e thjeshtuar*” me Nr. REF-68226-05-04-2023, me objekt: “Blerje materiale elektrike”, me fond limit 2.405.800 Lekë pa TVSH, parashikuar për t’u zhvilluar në datën 19.05.2023 nga autoriteti kontraktor, “ECO-ELB” SH.A.

II.2. Më datë 15.05.2023 operatori ekonomik “EVIA 20” SHPK, ka paraqitur ankesë me nr. 1052 prot., datë 15.05.2023 pranë Komisionit të Prokurimit Publik duke kërkuar modifikimin e dokumenteve të procedurës së prokurimit objekt-ankimi.

II.3. Në përputhje me nenin 112 “Veprimet paraprake” të ligjit nr.162/2020 “*Për Prokurimin Publik*”, Komisioni i Prokurimit Publik me marrjen e ankesës, e publikoi atë në bazën e të dhënave të tij, e cila përmban të dhëna për:

a) ankimuesin, adresën dhe NUIS-in; b) të dhëna të plota për procedurën e prokurimit (objekt, numër reference, fond limit, datën e zhvillimit të procedurës), si dhe ankesën e plotë të ankimuesit.

II.4. Në përfundim të afatit 5 ditor brenda të cilit autoriteti kontraktor ka detyrimin ligjor të trajtimit të ankesës dhe daljes me një vendim përfundimtar në lidhje me të, pranë Komisionit të Prokurimit Publik ka ardhur shkresa me nr. 253/1 prot., datë 22.05.2023, protokolluar me tonën me nr. 1052/3, datë 23.05.2023 me objekt “*Informacion*”, e Autoritetit Kontraktor i cili ka përcjellë pranë Komisionit të Prokurimit Publik, vendimin e Komisionit të Shqyrtimit të Ankesave. Referuar vendimit KSHA-së, në lidhje me trajtimin e ankesës AK nuk ka pranuar pretendimet e ankimuesit.

II.5. Me shkresën nr.1052/4 prot., datë 31.05.2023 me objekt “*Kërkesë për informacion*”, drejtuar autoritetit kontraktor, Komisioni i Prokurimit Publik kërkon informacion nëse operatori ekonomik ankimues “*EVIA 20*” SHPK ka paraqitur ankesë pranë autoritetit kontraktor.

II.6. Me shkresën nr. 300 prot., datë 02.06.2023, protokolluar me tonën me nr.1052/5, datë 06.06.2023, me objekt “*Kthim përgjigje*”, autoriteti kontraktor informon se operatori ekonomik “*EVIA 20*”SHPK, ka paraqitur ankesën pranë AK-së me nr. 253 prot, datë 16.05.2023.

### III

#### **Komisioni i Prokurimit Publik**

pas shqyrtimit të ankesës së operatorit ekonomik ankimues si dhe informacionit të autoritetit kontraktor,

#### **Arsyeton:**

III.1. Lidhur me pretendimet e ankimuesit për modifikimin e dokumenteve të tenderit të procedurës së prokurimit objekt-ankimi, i cili pretendon se: [*.. në kërkesat lidhur me pikën 2.3.2 të Kapacitetit teknik është kërkuar nga autoriteti kontraktor si vijon:*

**2.3.2** *Operatori ekonomik duhet të paraqesi një dëshmi nga administrata tatimore për punesimin mesatar jo më pak se 5 punonjës për te pakten muajin e fundit shoqëruar me Listëpagesat e sigurimeve shoqërore dhe vertetimim per pagesen e kontributeve. Kjo kërkesë do të përmbushet nëpërmjet Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit, ndërsa dokumentacioni provues, do të dorëzohët vetëm nga Operatori Ekonomik i kualifikuar i pari, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve ankimit, sipas përcaktimeve të bëra në pikën 6, të nenit 26, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, të ndryshuar.*

*....bazuar në objektin e prokurimit si edhe në volumin e kontratës, gjykojmë se kërkesa për këtë kriter është e ekzagjeruar dhe jo në përpjestim me volumin e saj. Kërkesa për 5 punonjësit nuk është e*

*nevojshme, pasi kërkohet vetëm furnizim jo vendosje ku kjo kërkesë do të ishte e nevojshme.....prandaj kërkohet heqjen e këtij kriteri..]*

III.1.1. Autoriteti Kontraktor me shkresën nr. 253/1 prot., datë 22.05.2023, protokolluar me tonën me nr. 1052/3, datë 23.05.2023 me objekt “Informacion”, ka përcjellë pranë Komisionit të Prokurimit Publik, vendimin e Komisionit të Shqyrtimit të Ankesave. Referuar vendimit të KSHA-së vërehet se AK nuk ka pranuar pretendimet e ankimuesit.

III.1.2. Referuar bazës ligjore në nenin 3 “Parime të përgjithshme” të ligjit 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, parashikohet shprehimisht se:

*“1. Autoritetet dhe entet kontraktore garantojnë trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për operatorët ekonomikë si dhe veprojnë me transparencë e në mënyrë proporcionale.*

*2. Autoritetet dhe entet kontraktore nuk duhet të shmangin fushën e zbatimit të këtij ligji ose të ngushtojnë në mënyrë artificiale konkurrencën. Konkurrenca konsiderohet se është ngushtuar artificialisht kur prokurimi përgatitet me qëllimin për të favorizuar ose dëmtuar në mënyrë të padrejtë operatorë ekonomikë të caktuar.*

*3. Autoritetet dhe entet kontraktore janë të detyruara të zbatojnë detyrimet e përcaktuara në legjislacionin mjedisor, social e të punës dhe në dispozitat e marrëveshjeve dhe konventat ndërkombëtare, të ratifikuara në përputhje me Kushtetutën.”*

Neni 21 pika 1 “Autoriteti ose enti kontraktor” i ligjit 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, parashikon shprehimisht se: *Autoriteti ose enti kontraktor është përgjegjës për prokurimin në përputhje me dispozitat e këtij ligji dhe të akteve nënligjore të nxjerra në zbatim të tij, duke garantuar respektimin e parimeve të trajtimit të barabartë, transparencës, konkurrencës dhe mosdiskriminimit, të parashikuara në këtë ligj.*

Neni 77 “Kërkesat për kualifikim”, të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, parashikohet shprehimisht se:

*“1. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë kërkesat për kualifikim për operatorët ekonomikë bazuar në:*

*a) përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale;*

*b) gjendjen ekonomike dhe financiare;*

*c) aftësinë teknike dhe profesionale.*

*Kërkesat kufizohen vetëm në ato që janë të përshtatshme për të garantuar që një kandidat ose ofertues të ketë kapacitetet juridike, financiare dhe aftësitë teknike e profesionale për të zbatuar kontratën që do të jepet. Të gjitha kërkesat duhet të kenë lidhje dhe të jenë proporcionale me objektin e kontratës”.*

*4. Në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë zotërojnë burimet e nevojshme njerëzore e teknike, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie*

III.1.3. Komisioni i Prokurimit Publik vlerëson se kriteret për kualifikim vendosen që t'i shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kapacitete teknike e profesionale, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës. Referuar legjislacionit të prokurimit publik, është në të drejtën e autoritetit kontraktor të përcaktojë kriteret për kualifikim, gjithnjë kur ato janë të nevojshme dhe të lidhura ngushtë me objektin e prokurimit dhe të bazuara në legjislacionin për prokurimin publik, duke mos i tejkaluar kufijtë të përcaktuar në këtë të fundit, në funksion të qëllimit dhe parimeve të ligjit për prokurimin publik. Autoriteti kontraktues është organi përgjegjës për prokurimin e fondeve publike, ndaj dhe përcaktimi i kriterëve të veçanta për kualifikim është lënë nën përgjegjësinë e autoritetit kontraktues, gjithnjë në përputhje e përpjesëtim me objektin, fondin limit dhe natyrën e kontratës së prokurimit.

Komisioni i Prokurimit Publik referuar pikës së parë të ankesës [*...se kriteri për paraqitje të dëshmisë për punësim mesatar jo më pak se 5 punonjës për të paktën muajin e fundit....është i panevojshëm dhe në kundërshtim me rregullat e prokurimit publik...*] vëren se operatori ekonomik argumenton ankesën e tij për këtë pikë si kërkesë joproporcionale e të panevojshme e cila, referuar objekti të prokurimit nuk është në proporcion me natyrën dhe objektin e prokurimit që është blerje mallrash e jo shërbim.

KPP vëren se, dokumentet e tenderit duhet të hartohen në përputhje me LPP-në dhe rregullat e prokurimit publik në mënyrë të tillë që të nxisin pjesëmarrjen dhe konkurrencën e operatorëve ekonomikë, të stimulojnë pjesëmarrjen e bizneseve si dhe të sigurojnë një trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për të gjithë operatorët ekonomikë, pjesëmarrës në këto procedura, për realizimin me sukses të kontratës me qëllim zgjerimin e rrethit të pjesëmarrjes së operatorëve ekonomikë në respekt të nenit 2 të LPP i cili parashikon shprehimisht se: *“Qëllim i këtij ligji është: a) të rrisë eficientë dhe efikasitetin në procedurat e prokurimit publik; b) të sigurojë mirëpërdorim të fondeve publike dhe të ulë shpenzimet procedurale; c) të nxisë pjesëmarrjen e operatorëve ekonomikë në procedurat e prokurimit publik; ç) të nxisë konkurrencën ndërmjet operatorëve ekonomikë; d) të sigurojë një trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për të gjithë operatorët ekonomikë, pjesëmarrës në procedurat e prokurimit publik; dh) të sigurojë integritet, besim publik dhe transparencë në procedurat e prokurimit publik.”*

Komisioni i Prokurimit Publik gjykon, se autoriteti kontraktor në përcaktimin e kërkesave për kualifikim duhet të ketë parasysh që të mos krijojnë konfuzion dhe të mos rëndojë operatorët ekonomikë me kërkesa të tepërta. Me të drejtë ankimesi ngre pretendime me argumente bindëse duke kundërshtuar kërkesën objekt ankimi si kërkesë që vështirëson operatorët ekonomikë në përgatitjen e ofertave dhe kufizon pjesëmarrjen e një numri sa më të madh operatorësh ekonomikë në procedurat e prokurimit.

Referuar sa më lart, Autoriteti Kontraktor duhet të heqë kriterin për kualifikim 2.3.2, si kriter i tepërt që kufizon pjesëmarrjen e operatorëve ekonomikë në përgjithësi dhe në veçanti të përfaqësuesve të biznesit të mesëm dhe të vogël me qëllimin final për të rritur konkurrencën.

Referuar arsytimit të sipërpërmendur Komisioni i Prokurimit Publik gjykon, se kërkesa e operatorit ekonomik ankimues për heqje të kriterit 2.3.2 qëndron.

III.2 Lidhur me pretendimet e ankimuesit për modifikimin e dokumenteve të tenderit të procedurës së prokurimit objekt-ankimi, Operatori Ekonomik “EVIA 20” SHPK ankimon Dokumenteve Standarde të Tenderit e më konkretisht pikën:

*2.3.7 Operatori ekonomik duhet të jete i pajisur edhe me certifikatat e mëposhtme të lidhura me objektin që kërkohet të prokurohet:*

Sistemi menaxhimit të cilësive ISO 9001 (e vlefshme) Qëllimi i certifikimit të operatorit ekonomik pjesëmarrës duhet të jetë në fushën e objektit që prokurohet

Sistemi menaxhimit të shëndetit dhe sigurimit në punë ISO 45001 (e vlefshme) Qëllimi i certifikimit të operatorit ekonomik pjesëmarrës duhet të jetë në fushën e objektit që prokurohet.

PAS 99-2012 sistemi i menaxhimit të integruar

*Çertifikatat të jenë lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë.*

*Në rastin e bashkimit të operatorëve ekonomik, sipas nenit 74 të VKM-914 datë 29.12.2014, secili operator ekonomik duhet të dorëzojë certifikata ISO sipas zërave të punëve/mallrave/shërbimeve që do të marrë përsipër të realizojë sipas aktmarrëveshjes.*

III.2.1. Autoriteti Kontraktor me shkresën nr. 253/1 prot., datë 22.05.2023, protokolluar me tonën me nr. 1052/3, datë 23.05.2023 me objekt “Informacion”, ka përcjellë pranë Komisionit të Prokurimit Publik, vendimin e Komisionit të Shqyrtimit të Ankesave. Referuar vendimit të KSHA-së vërehet, se AK nuk ka pranuar pretendimet e ankimuesit.

III.2.2. Komisioni i Prokurimit Publik vëren, se Autoriteti kontraktor, duke qenë se është përfituesi direkt i kontratës objekt-prokurimi, është në të drejtën e tij të garantohet, se operatorët ekonomikë pjesëmarrës i plotësojnë kërkesat e cilësisë për mallrat që kërkon të blejë, por këto kërkesa duhet të jenë të lidhura me objektin e prokurimit, në mënyrë që të mos rëndojnë pa të drejtë pozitat e operatorëve ekonomikë që shfaqin interes për të marrë pjesë në procedurën e prokurimit. KPP thekson faktin, se kriteret për kualifikim duhet të hartohen në përputhje me LPP-në dhe rregullat e prokurimit publik, në mënyrë të tillë që të nxisin pjesëmarrjen dhe konkurrencën e operatorëve ekonomikë, të stimulojnë pjesëmarrjen e biznesit të vogël dhe të mesëm, si dhe të sigurojnë një trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për të gjithë operatorët ekonomikë, pjesëmarrës në këto procedura.

Në lidhje me kërkesën e autoritetit kontraktor për disponimin e certifikatave ISO 9001, ISO 45001 dhe PAS 99-2012, Komisioni i Prokurimit Publik gjykon të ndalet në një test proporcionaliteti, së pari, nëse kërkesat në fjalë janë të përshtatshme për arritjen e synimit të kërkuar dhe së dyti, nëse këto kërkesa shkojnë përtej asaj, se çfarë është e nevojshme për të arritur synimin. KPP gjykon, se synimi bazë i kërkesës së autoritetit kontraktor për këtë procedurë prokurimi është sigurimi i mallrave të kërkuara dhe përmbushjes me sukses të kontratës dhe në përgjigje të testit të mësipërm të proporcionalitetit, kërkesat për disponimin e certifikatave: *ISO 45001 Sistemi menaxhimit të shëndetit dhe sigurimit në pune dhe PAS 99-2012 sistemi i menaxhimit të integruar*, nuk i shërbejnë synimit të autoritetit kontraktor dhe shkojnë përtej asaj, se çfarë është e nevojshme për realizimin e synimit. Referuar objektit të prokurimit AK prokuron blerje materiale elektike, që do të thotë, se kërkon thjesht të blejë mallra nga operatorët ekonomikë e jo ndonjë proces tjetër siç mund të jetë montimi i tyre në ambientet e autoritetit kontraktor. Për sa më sipër referuar Komisioni i Prokurimit Publik gjykon, se kërkesat për certifikatat ISO nuk janë në proporcion me objektin e prokurimit dhe nuk i shërbejnë realizimit të kontratës.

Në këtë kuadër autoriteti kontraktor duhet të marrë masa për heqjen e kërkesave për certifikatat:

- ISO 45001 Sistemi i menaxhimit të shëndetit dhe sigurimit në pune dhe
- PAS 99-2012 Sistemi i menaxhimit të integruar, për procedurën e prokurimit objekt ankimi.

Referuar arsytimit sipërcituar, pretendimet e operatorit ekonomik ankimues qëndrojnë.

Për sa më sipër, në mbështetje të nenit 30 dhe 118 të ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766, datë 13.10.2021 “Për miratimin e rregullave “Për Organizimin dhe Funksonimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 236, datë 20.04.2023 “Për përcaktimin e rregullave dhe tarifës së pagesës për ankimin në një procedurë prokurimi pranë Komisionit të Prokurimit Publik”, Nenit 4, të Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 “Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19”, Komisioni i Prokurimit Publik,

#### **Vendos:**

1. Të pranojë ankesën e operatorit ekonomik “EVIA 20” SHPK, për procedurën e prokurimit “Procedurë e hapur e thjeshtuar” me Nr. REF-68226-05-04-2023, me objekt: “Blerje materiale elektrike”, me fond limit 2.405.800 Lekë pa TVSH, parashikuar për t’u zhvilluar në datën 19.05.2023 nga autoriteti kontraktor, “ECO-ELB” SH.A.

2. Autoriteti kontraktor të modifikojë dokumentet e tenderit me publikimin e shtojcës përkatëse në përputhje me konstatimet e mësipërme të Komisionit të Prokurimit Publik.
3. Autoriteti kontraktor, brenda 5 ditëve, të vërë në dijeni Komisionin e Prokurimit Publik për zbatimin e këtij vendimi.
4. Ngarkohet zyra e financës që të bëjë kthimin e tarifës financiare të paguar nga operatori ekonomik ankimues “EVIA 20” SHPK.
5. Kundër këtij vendimi, mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Apelit, Tiranë.
6. Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

### **KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK**

**Nënkryetar**

**Fiorent Zguro**

**Anëtar**

**Kreshnik Ternova**

**Kryetar**

**Jonaid Myzyri**